



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 716 prot.

Tiranë, më 12 . 06 . 2023

V E N D I M

Nr. 105, datë 12 . 06 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 186 Regj., datë 01.12.2022³, të subjektit ankues M. Ç, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “për çdo shkak tjetër” nga ana e Drejtueses së Departamentit të Infermierisë, pranë Fakultetit të Shëndetit, të Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, M. Ç është pedagoge pranë Fakultetit të Shëndetit, në Universitetin “Ismael Qemali”, Vlorë që prej datës 25.07.2009 e në vijim. Ankuesja zotëron titullin akademik “Profesor i Asociuar”, mbështetur në parashikimin e nenit 59, pika 3, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në fillim të viti akademik 2022-2023, i është drejtuar me kërkesë me shkrim Drejtueses së Departamentit të Infermierisë, M. Z, për të qenë titullare në lëndët mësimore, ku ajo jep mësim që prej vitit 2009 e në vijim, përkatësisht për lëndët “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”, si dhe për t’u zgjedhur drejtuese e grupit kërkimor-shkencor të Departamentit të Infermierisë.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

³ Plotësuar nëpërmjet e-maileve të dërguara në vijim, depozituar në dosjen e subjektit ankues.

Ankuesja pretendon se, në mbledhjen e Departamentit të Infermierisë, znj. Z, propozoi si titullarë të lëndëve sipërcituar, pedagogët, të cilët kishin qenë të tillë edhe përgjatë vitit akademik 2021-2022 dhe anëtarët e Departamentit votuan pro Dr. A. N për lëndën e “Anatomisë së Njeriut” dhe Mcs. K. M për lëndën e “Histologjisë dhe Mikrobiologjisë”. Ndërkohë që, u vendos që Dr. E. A të ishte drejtuese e grupit kërkimor-shkencor të këtij Departamenti.

Ankuesja shprehet se, ajo e ka kundërshtuar një përzgjedhje të tillë në mbledhjen e Departamentit të Infermierisë, duke vënë në dukje faktin se, titullarja e lëndës së “Anatomisë së Njeriut”, A. N, mban titullin “Doktor i Shkencave”, ndërkohë që ankuesja mban titullin “Profesor i Asociuar”, titull më i lartë ky. Njëkohësisht, ankuesja vë theksin në faktin që A. N, e ka fituar titullin “Doktor i Shkencave”, për një periudhë kohore tepër të shkurtër, rreth 1 vit e 9 muaj, ndërkohë që në bazë të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, studimet e Doktoratës zgjasin për një periudhë disa vjeçare, pasi mbartin ngarkesë të konsiderueshme dhe detyrime të rëndësishme për t'u shlyer nga ana e doktorantit.

Ankuesja pretendon gjithashtu se, Mcs. K. M është përzgjedhur nga Drejtuesja e Departamentit në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 80/2015 dhe në vijim është votuar pro nga anëtarët e Departamentit të Infermierisë si titullar i lëndës “Histologjia dhe Mikrobiologjia”.

Znj. Ç parashtro kundërshtimet e saj për përzgjedhjen e votimin e E. A si përgjegjëse e grupit kërkimor-shkencor të këtij Departamenti. Në këtë kontekst, ajo ka cituar parashikimin e ligjit të sipërcituar, sipas të cilit:

“Departamenti organizohet në grupe mësimore e kërkimore. Grupi mund të jetë edhe vetëm kërkimor. Titullarët e grupeve duhet të kenë së paku gradën shkencore “Doktor” dhe përzgjidhen me konkurim të hapur, të drejtuar nga një komision ad-hoc, i ngritur nga Këshilli i Profesorëve. Procedurat e ngritjes së këtij komisioni dhe të konkurimit përcaktohen në statutin e institucioneve të arsimit të lartë. Titullari i njësisë bazë i propozon autoritetit drejtues të njësisë kryesore emërimin e kandidatit të renditur në vendin e parë të listës nga komisioni ad-hoc, për një periudhë 4 vjeçare”.

Referuar sa më sipër, ankuesja thekson faktin se, në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit skademik të kësaj kategorie, mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesoi i Asociuar”. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

Ankuesja evidenton faktin se, ajo ka një karrierë të gjatë akademike, që prej vitit 2009 dhe se, në dhjetor të vitit 2021 ka marrë titullin “Profesoi i Asociuar”, ndërsa E. A është punësuar në vitin 2008 dhe ka marrë gradën “Doktor i Shkencave” në dhjetor të vitit 2021.

Znj Ç deklaron se, E. A, në ciklin e tretë të provimeve ka zhvilluar vetëm 3 provime, pa frekuentuar asnjë ditë universitetin, në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Ankuesja pretendon se Dr. M. Z i ka kërkuar në mbledhjen e Departamentit të Infermierisë, që ajo të sjellë një material shtesë, nëpërmjet të cilit të provojë se çfarë ka ajo më tepër se pedagogët e tjerë që

janë vendosur titullarë të lëndëve të sipërcituara, apo se pedagogia që është vendosur si kryetare e grupit kërkimor-shkencor.

Ankuesja shprehet se i është përgjigjur znj. Z nëpëmjet shkresës me nr. 179/1 prot., datë 14.10.2022, shkresës me nr. 179/2 prot., datë 14.10.2022 dhe shkresës me nr. 191/2 prot., datë 17.10.2022.

Znj. Ç shprehet se, në vijim të shkresave të saj, përgjigjja zyrtare e Drejtueses së Departamentit ka qenë negative, duke i vënë në dukje faktin se znj. Ç nuk ka lidhje me infermierinë dhe mjekësinë e përgjithshme. Ankuesja shprehet se ajo ka dhënë provime të mjekësisë së përgjithshme si dhe provime të mjekësisë-stomatologjisë dhe se 85% e provimeve të saj i përkasin degës së mjekësisë së përgjithshme dhe 13.3% e tyre i përkasin mjekësisë stomatologjike.

Znj. Ç deklaron se është diskriminuar nga ana e Drejtueses së Departamentit, pasi në përgjigje të kërkesës së saj për t'u zgjedhur përgjegjëse e grupit kërkimor-shkencor të këtij Departamenti, citohet se:

“Pavarësisht faktit që kjo është kompetencë e Drejtuesit të Departamentit, për shkak të konfliktit të interes që ju keni hapur me Drejtuesin e Departamentit të Infermierisë, kërkesa juaj u votua në Departament dhe asnjë anëtar i tij nuk është dakord...”

Ndërkohë që, në kundërpërgjigje, znj. Ç thekson faktin se, neni 59, pika 3, e ligjit nr. 80/2015 kërkon që udhëheqësi i veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe titullari i lëndës duhet të mbajë titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.

Përveç sa më sipër, ankuesja shprehet se qendrimi i Drejtueses së Departamentit ka qenë i njëanshëm dhe si pasojë e faktit se dizertacioni i saj përmbante 49.15% plagjiaturë, ndërkohë që Këshilli i Etikës së Universitetit të Vlorës, dha një rezultat 5.99% plagjiaturë, fakt për të cilin ankuesja ka kryer një kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ndërkohë që, ajo shprehet se Drejtuesja e Departamentit e ka ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, krahasuar me pedagogë të tjerë që zotërojnë gradë shkencore më të ulët dhe janë përzgjedhur si titullarë të lëndëve “Anatomia e Njeriut” e “Histologjia e Mikrobiologjia”, apo si drejtues të grupit kërkimor-shkencor të Departamentit.

Subjekti ankues kërkon nga KMD, shfuqizimin e vendimeve të Drejtueses së Departamentit të Infermierisë, pranë Fakultetit të Shëndetit, të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, për caktimin e titullarëve të lëndëve “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia e Mikrobiologjia”, si dhe mbi caktimin e përgjegjës të grupit kërkimor-shkencor të këtij Departamenti.

- Në kuadër të parashtrimeve dhe dokumentacionit të dërguar në vijimësi pranë KMD-së, nga subjekti ankues, si në rrugë postare, ashtu dhe në rrugë elektronike (me email), Komisioneri evidenton faktin se ato janë depozituar në dosjen e ankueses dhe janë vlerësuar

gjatë vendimmarrjes së KMD-së, bashkërisht dhe në harmoni me pretendimet dhe faktet e provat e tjera.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankueses për diskriminim nga ana e Drejtueses së Departamentit të Infermierisë, pranë Fakultetit të Shëndetit, të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, gjatë marrëdhënieve të punës.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 153/2 prot., datë 13.12.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime Drejtueses së Departamentit të Infermierisë, pranë Fakultetit të Shëndetit, të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 267/1 prot., datë 22.12.2022, Drejtuesja e Departamentit të Infermierisë pranë Fakultetit të Shëndetit, të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e saj lidhur me pretendimet e subjektit ankues, duke bashkëlidhur edhe dokumentacion provues.

Ndër të tjera, Drejtuesja e Departamentit (DI), ka parashtruar se:

“Znj. Ç është e punësuar si pedagoge me kohë të plotë pranë Departamentit të Infermierisë pranë Fakultetit të Shëndetësisë, të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, Departament të cilin unë jam zgjedhur ta drejtoj që prej vitit 2016. Edukimi bazë i kësaj pedagogeje është Stomatologji, dhe si e tillë, fusha e saj e ekspertizës nuk është e përputhshme me asnjë modul të programit Bsc në Infermieri të Përgjithshme, që ofrohet nga Departamenti që unë drejtoj.

Nga përmbajtja e kurrikulës së këtij programi evidentohet qartë se nuk përmban asnjë modul me karakter stomatologjik apo dentar. Si e tillë, kjo pedagoge është e papërshtatshme për t’u angazhuar në mësimdhënie në programet e Departamentit të Infermierisë.

Përsa i takon lëndëve të formimit të përgjithshëm, ne angazhojmë specialistët e fushave përkatëse të punësuar në departamentet e tjera të Universitetit të Vlorës (p.sh biologjinë e japin biologë të Departamentit të Biologjisë, kiminë e japin kimistë të Departamentit të Kimisë, etj, ndërkohë që sipas pretendimit të znj. Ç, kushdo që ka bërë në shkollë të lartë biologji apo kimi mund të jetë lektor dhe titullar i lëndës përkatëse).

Përsa i takon lëndëve karakterizuese të programit, ato janë të ndara në pjesën mjekësore dhe në atë infermierore.

Për këtë arsye kriteri i parë i punësimit në DI ka qenë gjithmorbë zotërimi i diplomës në Mjekësi të Përgjithshme apo Infermieri të Përgjithshme (ose specialiteteve përkatëse në bazë të moduleve që ofrojmë).

Asnjëherë në 25 vite të ofrimit të programit Bsc në Infermieri të Përgjithshme nuk është kërkuar pedagog i fushës së Stomatologjisë, të gjitha kërkesat kanë qenë për pedagogë të fushave mjekësi e përgjithshme (ose specialist) dhe infermieri e përgjithshme (ose specialist). Në kuota shumë të kufizuara janë kërkuar specialistë përkatës për module të caktuara si:

Shëndet publik, Farmakologji apo Fizoterapi, module këto që janë pjesë të kurrikulës së këtij programi.

Znj. Ç është punësuar në këtë Departament në vitin 2009, pa procedurë të rregullt punësimi, pa kërkesë të Departamentit për punësim dhe pa vendim të ndonjë komisioni vlerësues. Thjesht i është imponuar Departamentit për ta katapultuar në mësimdhënie e moduleve paraklinike, që supozohej të ishin më të përafërtat me formimin e saj akademik. Në atë kohë unë nuk kam qenë në funksione drejtuese dhe nuk mbaj përgjegjësi për mënyrën e saj të punësimit. Pedagogia M. Ç u lejua të vazhdonte veprimtarinë e saj akademike në lëndët paraklinike: Anatomi, Histologji, Mikrobiologji, megjithëse nuk kishte përputhshmëri të plotë me formimin e saj akademik, por asnjëherë nuk ka qenë titullare moduli për arsyen e shpjeguar më sipër (dhe ka qenë dakord me vendimin e Departamentit derisa filloi konfliktin personal me mua si Drejtuese Departamenti) Po flasim për një periudhë kur njësia jonë akademike ishte në zhvillim dhe nuk i kishte plotësuar krejtësisht të gjitha standardet e kërkuara të Cilësisë në Arsimin e Lartë, standarde që po vijnë duke u plotësuar vit pas viti.

Procesi i Akreditimit prej Agjencisë ASCAL (2020-2022) e forcoi më tepër kërkesën e llogarisë për plotësimin e këtyre standardeve dhe një prej rekomandimeve të lëna në Raportin e Ekspertëve

ishte: “Të përputhet fusha e ekspertizës së lektorit me specialitetin përkatës të modulit”. Në këto kushte, edhe po të tolerohet mësimdhënia nga një pedagog i papërputhshëm me specialitetin e modulit, nuk mundet asesi që ky pedagog të vendoset titullar moduli.

Pedagogët A.N dhe K.M , të vendosur si titullarë në këto module janë pedagogët me formimin më të lartë profesional në fushat përkatëse. Zotërojnë diploma në Mjekësi të Përgjithshme, kanë përfunduar specializimet afatgjata 4-vjeçare në Mjekësi (diploma të ciklit të tretë të studimeve) dhe, edhe nëse nuk do ti lejojmë më të jenë titullarë lëndësh sepse nuk janë kategoria “Profesor”, në vend të tyre do të zgjidheshin pedagogë të tjerë të kësaj kategorie, por më së pari të përputhshëm me specialitetin e modulit, sipas standardeve të cilësisë së arsimit të lartë.

Përgjegjësja e Grupit kërkimor-shkencor të Infermierisë është propozuar prej meje tek Dekania e Fakultetit konform Vendmit nr. 79, datë 12.12.2016, të Senatit Akademik të UV, pika c/1, ku thuhet që propozimi bëhet për personel akademik të të dyja kategorive: Profesor dhe Doktor.

Propozimi bazohet tek grada shkencore dhe titulli akademik, por gjithashtu bazohet edhe tek kontributi kërkimor-shkencor për Departamentin. Pedagogia e propozuar zotëron diplomën Bsc në Infermieri të Përgjithshme, Master Shkencor në Infermieri , si dhe është Doktore Shkencash, me një kontribut të qenësishëm si koordinator e bienaleve shkencore të Departamentit (akredituara nga QKEV) dhe pjesëtare e disa projekteve kërkim-zhvillimi të Departamentit tonë, financuar nga UV dhe AKKSHI.

Për më tepër, Grupi kërkimor-shkencor i Infermieristikës duhet të ketë në drejtim një pedagoge me formim infermieror. Ndërkohë që pedagogia M. Ç nuk ka asnjë pjesëmarrje në veprimtaritë kërkimore të Departamentit, çdo aktivitet shkencor që ka bërë e ka krejtësisht individual dhe jo-bashkëpunues.

Për më tepër, për kandidaturën e Dr. E.A, për Përgjegjës të Grupit kërkimor-shkencor kam marrë mendimin e Departamentit në mbledhjen e datës 16.02.2022 dhe të gjithë anëtarët e Departamentit, përfshirë edhe ankuesen, kanë qenë dakord.

Pa u mbushur as një vit nga emërimi ligjor i znj. E. A (e cila po e kryen më së miri funksionin përkatës), znj. Ç bën kërkesë që të caktohet ajo Përgjegjëse e Grupit kërkimor-shkencor, pa patur asnjë arsye ligjore përse duhet të shfuqizohet një vendim i marrë sipas rregullave në fuqi.

Megjithatë, duke parë tendencën e ankueses për t’u konsideruar e diskriminuar prej meje, që nga momenti që ka nisur konfliktin personal me mua, çdo kërkesë të saj, e kam propozuar për votim në Departament dhe më duhet të theksoj faktin se në çdo votim të fshehtë apo të hapur që është bërë në Departament lidhur me çdo kërkesë të saj, ajo ka marrë vetëm votën e saj.

Në mënyrë të përsëritur pedagogia M. Ç ka vënë në diskutim integritetin tim akademik në të gjitha instancat e mundshme akademike, qeveritare, mediatike dhe gjyqësore që ekzistojnë në Republikën e Shqipërisë. Unë jam verifikuar prej tyre për të gjitha akuzat e ankueses dhe në asnjë rast të vetëm nuk ka dalë i vërtetë ndonjë prej pretendimeve të saj.

Në lidhje me dy pretendimet e ngritura pranë jush, si dhe në lidhje me përgjigjen time ndaj kërkesave që ajo mi drejton mua, por që unë i kam shtruar në Departament për vendimmarrje dhe

jam bazuar në votimin në Departament, znj. Ç ka bërë ankesë edhe tek Dekania e Fakultetit, përgjigjja e së cilës ka qenë në favor të vendimeve të Departamentit”.

Drejtuesja e Departamentit ka theksuar faktin se, ankuesja ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të Drejtueses së Departamentit të Infermierisë, ndërkohë që vendimet janë të Departamentit dhe jo të Drejtueses së tij.

Në përfundim të parashtrimeve të saj, Drejtuesja e Departamentit shprehet se ankuesja jo vetëm nuk është diskriminuar, por është favorizuar duke u lejuar të zhvillojë veprimtarinë akademike në module pa përputhshmëri të plotë me formimin e saj akademik.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 290 prot., datë 20.02.2022, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, në datën 09.03.2022, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit.

Lidhur me trajtimin me sa më objektivitet të çështjes, si dhe në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor, Komisioneri ka kërkuar paraprakisht, që palët në proces të sjellin informacion, prova, si dhe fakte të reja, që mund të mbështesin pretendimet e tyre, lidhur me sa më sipër.

3. Seanca u zhvillua në datë 09.03.2022, me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues, M. Ç dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, Drejtueses së Departamentit të Infermierisë, M. Z.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsyetimit të vendimit.

- Në kuadër të parashtrimeve dhe dokumentacionit të dërguar pas seancës dëgjimore pranë KMD-së, nga palët, Komisioneri evidenton faktin se ato janë analizuar e vlerësuar gjatë vendimmarrjes së KMD-së, në harmoni me pretendimet dhe faktet e provat e tjera.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me pedagogët e tjerë të Departamentit të Infermierisë së Fakultetit të Shëndetit, në Universitetin e Vlorës, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

A.1 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e Drejtueses së Departamentit, krahasuar me E.A, Përgjegjësen e grupit kërkimor-shkencor.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Nga përmbajtja e procesverbalit të mbajtur në takimin e datës 16.02.2022, me temë: “Propozime për kryetarin e grupit mësimor dhe grupit kërkimor-shkencor, në Departamentin e Infermierisë, rezulton se lidhur me drejtuesin e grupit kërkimor-shkencor, Drejtuesja e DI ka propozuar për kryetare të tij, Dr. E. A.

Nga 12 (dymbëdhjetë) anëtarët pjesëmarrës të Departamentit, përfshirë edhe subjektin ankues, të gjithë kanë miratuar propozimin e Drejtueses së DI, duke u dakordësuar me kandidaturën e propozuar, pasi të gjithë kanë votuar e firmosur pro saj.

Me shkresën me nr. 29/1 prot., datë 16.02.2022, Drejtuesja e Departamentit, i është drejtuar Dekanes së Fakultetit të Shëndetit pranë Universitetit të Vlorës, lidhur me propozimet për anëtarët dhe drejtuesit e dy grupeve: grupit mësimor të Infermierisë dhe grupit kërkimor-shkencor të Infermierisë. Lidhur me grupin e fundit, Drejtuesja e DI, ka propozuar për drejtues të tij Dr. E. A, propozime të cilat janë miratuar prej saj (anëtarët dhe drejtuesit e të dy grupeve përkatëse).

Me shkresën me nr. 179 prot., datë 03.10.2022, subjekti ankues i është drejtuar Drejtueses së DI, duke kërkuar të jetë drejtuese e grupit kërkimor-shkencor.

Kjo kërkesë është përsëritur sërish nëpërmjet shkresës me nr. 191/2 prot., datë 17.10.2022 dhe nëpërmjet saj ankuesja është vetëkandiduar duke kërkuar propozimin e saj si përgjegjëse e grupit kërkimor-shkencor. (Kërkesë e ripërsëritur edhe me shkresën me nr. 191/4 prot., datë 03.11.2022, drejtuar Dekanes dhe Drejtueses së DI).

Nga ana e Drejtueses së DI, nëpërmjet shkresës me nr. 191/1 prot., datë 14.10.2022, ankueses i është kthyer përgjigje lidhur me këtë pretendim, duke e informuar, ndër të tjera se, përgjegjësja aktuale e grupit kërkimor-shkencor të DI është emëruar konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe se ajo është duke e kryer detyrën me sukses dhe se nuk ka asnjë klauzolë në Rregulloren e Universitetit për të bërë ndryshimin e këtij emërimi, vetëm 8 muaj pas emërimit të saj, sa kohë nuk plotësohen kushtet për largimin e saj.

Po ashtu, evidentohet se, pavarësisht faktit se propozimi për kryetarin apo përgjegjësën e grupit kërkimor-shkencor të DI, është kompetencë e Drejtuesit të Departamentit, për shkak të konfliktit të interesit mes ankueses dhe Drejtueses së DI, kërkesa e saj është hedhur për votim në Departament dhe asnjë anëtar i DI (përveç vetë ankueses) nuk ka qenë dakord që përgjegjësja aktuale e këtij grupi të zëvendësohej nga ankuesja.

Komisioneri ka analizuar e vlerësuar veprimet e Drejtueses së DI, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që kanë qenë në fuqi në periudhën e emërimit të Dr. E.A në detyrën e përgjegjësës së grupit kërkimor-shkencor, pasi lidhur me emërimin e saj ankuesja ka pretenduar se është përzgjedhur në shkëlqje të përcaktimeve të tyre ligjore.

Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3⁴ të tij ka përcaktuar se:

“1. Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Liria akademike garantohet nëpërmjet së drejtës:

a) për të organizuar veprimtarinë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese;

b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;

c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.”.

Neni 33, pika 3 e tij, e këtij Ligji, përcakton se:

“Institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e tyre përbërëse rregullojnë veprimtarivë e tyre në rregulloret e tyre të brendshme, që harohen dhe miratohen në përputhje me këtë ligj dhe sipas mënyrës së përcaktuar në statutin e institucionit të arsimit të lartë”.

Në nenin 45, të këtij ligji përcaktohet se: *“1. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë. Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë...4. Drejtuesi mund të shërbejë në detyrë për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë... 6. Funkcionet e drejtuesit të njësisë bazë rregullohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë”.*

Statuti i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, i ndryshuar, në nenin 38, pika 1, shkronja h) të tij, ka përcaktuar kompetencat e drejtuesit të njësisë bazë, i cili ndër të tjera ushtron dhe këto funksione:

“...drejtuesi i njësisë bazë i propozon dekanit për miratim përgjegjësit e grupeve mësimore dhe kërkimore”.

Në nenin 34, të po këtij akti rregullator përcaktohet kompetenca e dekanit për miratimin e propozimit të drejtuesit të njësisë bazë lidhur me sa më sipër.

Neni 30, i këtij Statuti, në pikën 1, të tij, përcakton Rektorin si autoritetin më të lartë akademik të UV-së, dhe përfaqësues ligjor të tij për çështjet akademike dhe protokollare.

Neni 31, i Statutit, përcakton funksionet e Rektorit, ndër të tjera, (pika 14 e tij) duke përcaktuar se ai: *“Mund të kthejë për rishqyrtim apo të anullojë, shfuqizojë vendimet e drejtuesve të njësisve kryesore dhe njësisve bazë, kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë statut, rregullorene UV-së dhe vendimet e Senatit Akademik”.*

Rregullorja e Departamentit të Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, është akt nënligjor rregullator i miratuar me Vendimin nr. 10, datë 30.05.2013, të

⁴ Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë.

Këshillit të Fakultetit të Shëndetit Publik Vlorë, e ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik të UV, me nr. 34, datë 24.03.2017, e cila në nenin 2 të saj ka përcaktuar se:

“Misioni i Departamentit të Infermierisë, si njësi bazë ë FSHP, bazuar dhe në statusin e UV, është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj të tretëve. Bazuar në programet mësimore bashkëkohore, synon të formojë specialist të lartë në fushën e kujdesit shëndetësor, të kualifikuar dhe të përshtatshëm për tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore.

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore-shkencore dhe administrative të Departamentit të Infermierisë, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të tij dhe e shtrin veprimin e saj mbi njësinë bazë, personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor, personelin administrativ, studentët, bashkëpunëtorët e departamentit si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që vepron në objektet apo territorin e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.

Rregullorja përcakton misionin e programeve të studimit dhe vendos rregullat normative të organizimit të tyre, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunëtorëve, rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për kërkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin, për publikime, për rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores”.

Neni 10, i kësaj Rregulloreje, ndër të tjera, përcakton se:

“1.Drejtuesi i departamentit është autoriteti më i lartë për departamentin. Në veprimtarinë e tij mbështetet dhe përfaqëson mendimin e personelit akademik të departamentit.

2. Veç detyrave të tjera të përcaktuara nga aktet normative në fuqi, përgjegjësi i departamentit ka edhe këto detyra për ushtrimin e funksioneve të tij:

a.

b. Mbikëqyr dhe koordinon veprimtarinë e grupeve mësimore dhe kërkimore-shkencore.

c. I propozon dekanit drejtuesin e grupit mësimor dhe atij kërkimor-shkencor. Përzgjedhja nga drejtuesi i departamentit bëhet mbi bazë kriteresh, titujsh, gradës, performancës, kontributit shkencor, akademik dhe pedagogjik të personelit akademik”.

Nëpërmjet Vendimit nr. 79, datë 12.12.2016 “Për funksionimin e grupeve mësimore, grupeve të përkohshme/të përhershme kërkimore-shkencore dhe standardet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore vjetore në auditor”, Senati Akademik i UV, ka vendosur, se:

“.....

2.Grupet mësimore dhe grupet e përhershme/e përkohshme me karakter kërkimor-shkencor nuk janë njësi përfaqësuese, të pavarura dhe të mëvetësishme. Veprimtaria e tyre është gjithmonë në funksion të detyrave dhe misionit të departamentit, të parashikuara në ligjin e arsimit të lartë dhe akteve të tjera nënligjore”.

Pika C/1, e tij përcakton se:

“Për rolin, funksionin dhe detyrat e përgjegjës të grupit mësimor apo grupit të përhershëm/të përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor në departamente.

1. Çdo grup mësimor apo grup i përhershëm/i përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor do të ketë përgjegjësin e tij të zgjedhur (nga kategoria e personelit akademik “Profesor” dhe “Doktor”), sipas kritereve dhe procedurave të propozuara nga vetë departamentet dhe fakultetet respektive, kritere dhe procedura të cilat do të pasqyrohen në Statutin dhe Rregulloren e re të UV- së”.

Duke analizuar gjithë sa më sipër, si dhe kronologjinë e veprimeve të kryera nga Drejtuesja e DI, Komisioneri vlerëson se:

- Lidhur me propozimin e kandidaturës së Dr. E. A, përcjellë tek Dekani, Drejtuesja e DI, ka ushtruar kompetencën e saj konform gjithë aktetve ligjore e nënligjore në fuqi dhe në përmbushje të tyre.
- Propozimi i saj është diskutuar në Departament me anëtarët e tjerë (procesverbali imbledhjes së datës 16.02.2022).
- Të gjithë anëtarët janë shprehur dakord me propozimin e kandidaturës së Dr. E. A, edhe vetë subjekti ankues.
- Ankuesja nuk ka shprehur rezerva apo kundërshti lidhur me mosplotësimin e ndonjë kriteri apo ane formale nga ana e kandidaturës në fjalë.
- Ankuesja plotëson kriteret e përcaktuara për përgjegjëse të grupit kërkimor-shkencor, konform akteve rregullatore për sa më sipër. Kandidatura për këtë pozicion duhet të jetë personale akademik i njëjës prej kategorive: Profesor dhe Doktor.
- Referuar dokumentacionit përkatës rezulton se edhe Dr. E. A plotëson kriteret e përcaktuara. Ajo është pedagoge me formim infermieror, zotëron diplomën Bsc Infermieri të Përgjithshme, Master Shkencor në Infermieri, si dhe Doktore e Shkencave, si dhe me një kontribut të qenësishëm për DI (Dokumentacioni provues për secilën ndodhet i depozituar në dosjen e ankueses).
- Pra, konform përcaktimeve sa më sipër, Drejtuesja e DI ka ushtruar të tagrin e saj për propozimin e kandidaturës së Dr. E. A.
- Komisioneri, evidenton faktin se gjatë mbledhjes së datës 16.02.2022, kur është propozuar kjo kandidaturë, ankuesja ka qenë pro saj, dhe në asnjë moment nuk ka ngritur pretendimin se duhet të ishte ajo apo të jetë vetëpropozuar me argumentin se zotëron gradën Profesor i Asociuar, pavarësisht se referuar akteve të depozituara prej saj ajo dispononte dokumentin provues në këtë periudhë⁵.
- Komisioneri nuk gjen të arsyetuar kërkesën apo vetëpropozimin e ankueses, brenda 8 (tetë) muajve nga emërimi i pedagoges E. A si përgjegjëse e grupit kërkimor-shkencor, pasi ajo ushtronte brenda këtij tagri këtë funksion.
- Nuk rezulton të jetë shpallur vakancë për këtë pozicion apo të jetë bërë ndonjë shpallje për të.

⁵ Dëshmi për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar” e znj. M. Ç, me nr. Regjistri të GSHTA 13126, Nr. i RTA 54, të datës 10.06.2022, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe vërtetimit (muaji janar 2022) lëshuar nga autoriteti kompetent, para regjistrimit të titullit në regjistrin e GSHTA.

- Ankuesja nuk ka pretenduar, dëshmuar apo provuar në ndonjë formë që Dr. E. A nuk kishte realizuar apo përmbushur këtë detyrë të saj dhe që duhej zëvendësuar.
- Për më tepër, Komisioneri evidenton faktin se vendimmarrja e DI (16.02.2022) është kolegjiale dhe unanime për të tepër në këtë rast (konsideruar edhe vetë dakordësinë e ankueses). Pra, Drejtuesja e DI nuk ka rol vendimmarrës por thjesht propozues dhe ka të drejtën e një vote, mes 12 kolegësh, anëtarë të DI.
- Nga ana tjetër, edhe pse nuk kishte asnjë detyrim ligjor për ta bërë, Drejtuesja e DI, (për shkak të konfliktit të pranuar nga të dyja palët) sërish ka kaluar për diskutim në Departament vetëpropozimin e ankueses⁶, me datë 13.10.2022, i cili në mënyrë unanime (përveç vetë ankueses) është refuzuar dhe nuk është pranuar.
- Komisioneri vëren gjithashtu, se personi kompetent për të verifikuar veprimet apo mosveprimet e Drejtueses së DI lidhur me ligjshmërinë apo jo të tyre, është Dekani.
- Në këtë kontekst, kërkesat e pretendimet e ankueses për parregullsi dhe paligjshmëri përsa i takon mosrespektimit të kritereve të përgjegjësive aktuale të grupit kërkimor-shkencor, i janë nënshtruar ankimit hierarkik tek Dekani dhe Rektori i UV, të cilët i kanë kthyer përgjigje znj. Ç, duke vlerësuar të drejta dhe konform përcaktimeve ligjore të akteve në fuqi veprimet e Drejtueses së DI, lidhur me kompetencën e ushtruar prej saj për propozimin e kandidaturës së përgjegjësive aktuale të grupit kërkimor-shkencor. Dekania i ka bërë të ditur ankueses se në rast se nuk ka zgjedhje të parakohëshme apo largime vullnetare nga pozicioni i emëruar, propozimet nuk ribëhen më⁷.

Nuk rezulton që nga ana e ankueses të jetë ankimuar vendimmarrja e Dekanes së Fakultetit, (pasi Dekani është autoriteti vendimmarrës lidhur me kandidaturën e propozuar nga Drejtuesi i Departamentit, për përgjegjësinë e grupit kërkimor-shkencor) në shkallë të tjera hierarkike brenda Universitetit (siç është autoriteti i Rektorit, i cili, bazuar në kompetencat e tij, mund të kthejë për rishqyrtim apo të anulojë, shfuqizojë vendimet e drejtuesve të njësive kryesore dhe njësive bazë, kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë statut, rregullorene UV-së dhe vendimet e Senatit Akademik) apo në organet e tjera administrative apo gjyqësore.

Në këtë logjikë, Komisioneri vlerëson se, përsa kohë lidhur me sa më sipër, nuk konstaton veprime të paligjshme nga ana e Drejtueses së DI, lidhur me propozimin dhe veprimet e kryera prej saj lidhur me këtë procedurë të caktimit të përgjegjësive aktuale e grupit kërkimor-shkencor pranë DI (pedagoges E. A), për rrjedhojë edhe pretendimi e ankueses se nga ana e Drejtueses së DI janë ezauruar paligjshmëri e veprime jashtë kompetencave të saj, nuk qëndron pasi është i pabazuar në prova, fakte e legjislacion.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtueses së Departamentit

⁶ Referuar shkresës me nr. 179 prot., datë 03.10.2022, kërkesë e përsërtur rishtaz me datë 17.10.2022 dhe 03.11.2022.

⁷ Shkresa me nr.212/3 prot., datë 22.11.2022, e Dekanes së FSH.

të Infermierisë, lidhur me propozimin e procedurën e ndjekur për caktimin e përgjegjësës së grupit kërkimor-shkencor të DI.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuuese nga ana e Drejtueses së DI, kundrejt subjektit ankues, ardhur për shkak të gjendjes arsimore të saj apo për shkak të konfliktit të krijuar mes tyre, lidhur me momentin sipërcituar.

A.2 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e Drejtueses së Departamentit, krahasuar me titullarët e lëndëve “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve, si dhe në analizë të legjislacionit specifikuar në vijim, rezulton se:

Nëpërmjet shkresave me nr. 179 prot., datë 03.10.2022 dhe me nr. 191 prot., datë 10.10.2022, subjekti ankues i është drejtuar Drejtueses së Njesisë bazë/DI, duke kërkuar të jetë titullare e lëndëve “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”.

Referuar akteve të depozituara, rezulton se, para fillimit të vitit akademik 2022-2023⁸, me datë 13.10.2022 në Departamentin e Infermierisë, me pjesëmarrjen e anëtarëve të këtij Departamenti, është zhvilluar një mbledhje me temë: “Miratimi i Titullarëve dhe Literaturës në të dy ciklet e studimit për vitin akademik 2022-2023”.

Në përfundim të diskutimeve të bëra nga anëtarët e DI, përfshirë edhe ankuesen, rezulton se nga ana e Drejtueses së DI janë hedhur për votim për Titularë të lëndëve “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”, kandidaturat e pedagogëve A. N dhe K. M, të cilët kanë marrë miratimin e dakordësinë e anëtarëve të Departamentit, përveç votës së ankueses. Në këto kushte, anëtarët e Departamentit kanë miratuar këto dy kandidatura.

Shkresës me nr. 202 prot., datë 13.10.2022 “Vendim me nr. 21, datë 13.10.2022 “Për përcaktimin e titullarëve të moduleve në programin e ciklit të parë në Departamentin e Infermierisë”, të Drejtueses së Departamentit, nëpërmjet të cilës janë përcaktuar titullarët e moduleve të Ciklit të Parë, Bachelor në Infermieri të Përgjithshme pranë DI, i është bashkëlidhur “Lista e titullarëve të lëndëve në Bsc në Infermieri të Përgjithshme për vitin akademik 2022-2023”, shkresë e cila i është përcjellë për dijeni Dekanes së FSH.

Referuar kësaj liste të bashkëlidhur vendimit sipërcituar, lidhur me dy pedagogët me të cilët ankuesja është krahasuar, evidentohen të dhënat si më poshtë:

Lënda	Titullari i lëndës	Tituli akademik	Kualifikimi
Anatomi humane	A. N	Dr+SPA	Mjeke
Histologjia dhe	K. M	Dr PhDc+SPA	Mjek

⁸ Viti akademik 2022-2023 ka filluar me datë 17.0.2022.

Me shkresën me nr. 191/1 prot., datë 14.10.2022 Drejtuesja e DI, i ka komunikuar ankueses vendimin sipërcituar, si dhe i ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën e saj për t'u bërë titullare e lëndëve “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”, duke parashtruar ndër të tjera, se:

“Kjo kërkesë u shtrua për diskutim në Departament në mbledhjen e datës 13.10.2022 ku u miratuan titullarët e lëndëve dhe asnjë anëtar i Departamentit (veç jush) nuk është dakord me kërkesën tuaj, pasi:...

- *Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë është dokumenti kryesor për të gjitha proceset dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ai përcakton standardet shtetërore të cilësisë, të detyrueshme për zbatim prej institucioneve të arsimit të lartë.*
- *Bazuar në Standardin II.5, pika 4 të këtij Kodi, fusha juaj e studimeve në Stomatologji nuk përputhet me drejtimin e Departamentit të Infermierisë në Infermieri të Përgjithshme dhe Mjekësi të Përgjithshme.*
- *Bazuar në Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 44, datë 03.06.2022 për “Akreditimin e Parë të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Infermieri të Përgjithshme të Universitetit Vlorë”, i cili konstaton si mangësi të parë: “Fusha e ekspertizës e disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, nuk është në përputhje me lëndët që ata mbulojnë”, Departamentit i duhet të marrë masa për të përmbushur rekomandimet e lëna dhe fusha juaj e ekspertizës (Stomatologjia) nuk është në përputhje me lëndët “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”, si dhe me asnjë nga lëndët e programeve që ky Departament ofron”.*

Me shkresat me nr. 191/3 prot., datë 20.10.2022 dhe me nr. 191/4 prot., datë 03.11.2022, ankuesja i është drejtuar Dekanes së Fakultetit të Shëndetit dhe Drejtueses së DI, duke parashtruar objeksionet e saj lidhur me refuzimin për caktimin e saj si titullare për lëndët “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”.

Subjekti ankues lidhur me sa i është parashtruar nga ana e Drejtueses së DI, duke i bërë me dije se, fusha saj e studimit Stomatologjia, nuk përputhet me drejtimin e Departamentit të Infermierisë në Infermieri të Përgjithshme dhe Mjekësi të Përgjithshme, dhe se Stomatologjia nuk përputhet me lëndët “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”, dhe ndër të tjera, ajo ka argumentuar se:

- Studimet i ka përfunduar në vitin 2006 si Mjeke Stomatologe, në “Sapienza”, Romë, me mesatare 9.0.
- Diploma e saj si Mjeke Stomatologe është gjithëpërfshirëse, ku përfshihen këto dy lëndë dhe për më tepër përfshin të gjitha lëndët që zhvillohen në Programin Mësimor Bachelor në Infermieri të Përgjithshme.
- Ka zhvilluar Kirurgji orale dhe në vitin e parë zhvillohet anatomia e kokës dhe qafës.
- Performanca e saj në këtë lëndë është depozituar në sekretarinë e Fakultetit.

- Në vitin 2015 ka marrë gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, në drejtimin Anatomia e Njeriut dhe shprehet që kriteri “Master i Shkencave” Mjeke Stomatologe nuk mund të jetë përjashtues për të.
- Në vitin 2009, në faqen e internetit të UV ishte si kriter punësimi, përparësia e kandidatëve të cilët kishin studiuar në BE, dhe se ajo zotëronte ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë “Master i Shkencave”.
- Për periudhën korrik 2009-dhjetor 2015 ka mbajtur pozicionin asistent-lektor me kohë të plotë për leksionet, seminarët dhe laboratorët e këtyre dy lëndëve
- Plotëson kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë një pedagog.
- Zotëron Diplomë Doktorale me nr. 0158 regj dhe ka fituar gradën shkencore “Doktor” në lëndët paraklinike, duke cilësuar se ky është një kualifikim më i thelluar i njohurive për kriterin e vendosur “Master i Shkencave”.
- Po ashtu, ajo zotëron titullin akademik “Profesor i Asociuar”, titull që është i duhuri për pozicionin e titullares së këtyre dy lëndëve.

Me shkresën me nr. 212/3 prot., datë 22.11.2022, Dekania e FSH, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke e informuar, ndër të tjera se:

“Ju nuk jeni dakord me pozicionin e pedagogëve që keni përmendur në shkresën tuaj, e keni bërë të ditur mendimin tuaj në mbledhjen e Departamentit dhe vendimmarrja ka kaluar në votim, përfundimisht ka hyrë në fuqi propozimi më i votuar në mbledhjen e Departamentit-ky është një proces vendimmarrës mëse demokratik, i cili nuk ka sesi të kontestohet as nga unë, as nga askush tjetër.

Ju i jeni referuar detyrimit të Drejtueses së Departamentit për t’u konsultuar me eprorët dhe anëtarët e tjerë të stafit akademik për caktimin e titullarëve të moduleve. Në datën 13.10.2022 Drejtuesja e DI ka thirrur në mbledhjen e Departamentit pikërisht me këtë objekt dhe Departamenti ka marrë një vendim kolegjal të pakontestueshëm për këtë çështje. Ju keni qenë prezent në mbledhje dhe i keni shprehur opsionet tuaja, por vota e shumicës ka prevaluar. Kështu që unë nuk kam asnjë argument për ta kundërshtuar këtë proces të rregullt.

Eshtë e vërtetë që titullarët e moduleve duhet të jenë të kategorisë “Profesor”, por ata më së pari duhet të kenë formim akademik në fushën përkatëse të modulit, siç kërkohet në standardet e cilësisë dhe siç u evidentua në Raportin e Vlerësimit të Ekspertëve të Jashtëm nga ASCAL. Ndërkohë që formimi juaj akademik është në fushën e stomatologjisë dhe jo të mjekësisë paraklinike. Titullari i lëndës duhet të jetë i kategorisë “Profesor”, por më së pari duhet të ketë formim akademik të plotë në fushën që trajton moduli. Unë kam bërë lëndën e Statistikës në formimin tim akademik bachelor, master dhe SPA, por askush nuk mund të më marrë në konsideratë që unë të jap modulin e Statistikës në Departamentin e Matematikës. Kjo situatë që përshkrova është e njëjtë me situatën tuaj. Formimi juaj akademik nuk është plotësisht i përshtatshëm as për të qenë lektore në këto lëndë (një dukuri që është vënë në dukje edhe nga Raporti i Ekspertëve të Jashtëm nga ASCAL), kështu që emërimi si titullare do të ishte fare i papërshtatshëm.

Duke pasur parasysh argumentet e mëspërme, vendosa:

....

Titullarët e lëndëve janë vendosur në mënyrë kolegjiale me vendim departamenti, ndaj nuk ndryshojnë.”.

Lidhur me pretendimin e ankueses për tu bërë titullare e këtyre dy lëndëve, Drejtuesja e DI, nëpërmjet shkresës me nr. 267/1 prot., datë 22.12.2022, ka njohur Komisionerin, me qëndrimin e saj, duke parashtruar të njëjtat argumenta si sipërcituar, lidhur me faktin që edukimi bazë i saj është Stomatologji dhe si i tillë, fusha e saj e ekspertizës nuk është e përputhshme me asnjë modul të programit Bsc në Infermieri të Përgjithshme, që ofrohet nga DI. (Referuar shkresës me nr.267/1 prot., datë 22.12.2022 të Drejtueses së DI, cituar në faqen 4-7, të këtij vendimi).

Referuar dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, për secilën nga pedagogët e emëruar titullarë të lëndëve, respektivisht për lëndën “Anatomia e Njeriut”, pedagogia A. N dhe për lëndën “Histologjia dhe Mikrobiologjia”, pedagogu K. M, rezulton se:

Pedagogia A. N është titullare e lëndës “Anatomia e Njeriut”, për vitin akademik 2022-2023, vendosur kolegjialisht me Vendimin nr. 21, datë 13.10.2022, të DI.

- Jetëshkrimi/ CV e pedagoges A. N⁹ është i publikuar në faqen zyrtare të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.
- Zotëron diplomën në degën e Mjekësisë së Përgjithshme dhe me anë të saj i jepet titulli Mjeke e Përgjithshme.
- Dëshmi e specializimit pasuniversitar, patologe e specializuar, mjeke patologe, për sëmundjet e brendshme.
- Master të Nivelit të Dytë në Mjekësi, me drejtim Shëndet Publik.
- Me Diplomën e Doktoratës, me nr. diplome 0060, datë 16.12.2014, ka fituar gradën shkencore “Doktor” në “Lëndët Paraklinike”.
- Ka ushtruar profesionin e mjekut pranë Spitalit Rajonal Fier që nga viti 1985 e në vitin 1991. Nga viti 1991-2003 mjeke e përgjithshme/mjeke patologe pranë Qendrës Shëndetësore Vlorë.
- Nga 2009 e në vijim ushtron dhe profesionin e pedagoges në IAL.

Pedagogu K. M është titullar i lëndës “Histologjia dhe Mikrobiologjia”, për vitin akademik 2022-2023, vendosur kolegjialisht me Vendimin nr. 21, datë 13.10.2022, të DI.

- Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga DI/UV, K. M rezulton që përveç diplomës së integruar si “Mjek i Përgjithshëm”, zotëron edhe dy diploma të ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv”, “Specializim Afatgjatë” dhe “Doktor i Shkencave¹⁰”, respektivisht:
- Dëshmi Specializimi Afatgjatë” me nr. regj. 615, datë 29.10.1997, ku evidentohet se ka mbaruar kursin pasuniversitar të Laboratorit të Biokimisë, në Fakultetin e Mjekësisë.
- Vërtetim me nr. 568 prot., datë 19.06.2015, i Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Vlorë, me anën e të cilit vërtetohet se mjeku K. M ka punuar si Mjek Biolog pranë Laboratorit

⁹ <https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2015/02/Aferdita-Nikaj-CV.pdf> (e pa përditësuar)

¹⁰ Cituar edhe si kandidat për Phd

Mikrobiologjik në Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë Vlorë, për rreth 13 vite, nga viti 1993-2006.

- Dëshmi Kualifikimi me nr. 951 prot., datë 15.09.2004, i Institutit të Shëndetit Publik Tiranë (ISHP), e cila vërteton se për periudhën janar 1991-qershor 1992, K. M ka kryer kualifikimin pasuniversitar në Bakteriologji dhe Viriologji, pranë ISHP.
- Master në Mjekësi, me drejtim Laborator Mjekësor
- Dëshmi kualifikimi e Dr. K. M nga Universiteti i Pisës, Itali, lidhur me “Teknikat laboratorike të analizave kimiko-klinike dhe bakterilogjike”.

Pedagogia M. Ç, subjekti ankues¹¹ është Lektore pranë DI/FSH, Universiteti i Vlorës, dhe ushtron mësimdhënien pranë këtij Departamenti që prej vitit 2009 e aktualisht.

Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga ankuesja, rezulton se:

- Me “Dëshminë për njohje diplome” me nr. regj. 1992, datë 05.10.2009, të Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Njohjes së Diplomave pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, është bërë njohja e diplomës së M. Ç, lëshuar nga Universiteti i Romës “La Sapienza”, Itali, me programin 5 vjeçar në Odontoiatri dhe Protezë Dentare si Dilomë të Inegruar të Nivelit të Dytë.
- Me Diplomën e Doktoratës, me nr. diplome 0158, datë 08.03.2016, ka fituar gradën shkencore “Doktor” në “Lëndët Paraklinike”.
- Me Dëshminë me nr. regj. të GSHTA 13126, datë 10.06.2022, të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, ka fituar titullin “Profesor i Asociuar”.

Argumenti i dhënë nga Drejtuesja e DI, lidhur me përzgjedhjen e dy pedagogëve¹² me të cilët ankuesja krahasohet për të qenë titullare lëndëve përkatëse është se, ata të dy plotësojnë kriterin specifik të edukimit bazë, që është diploma në Mjekësi të Përgjithshme, në ndryshim nga ankuesja që zotëron diplomë të edukimit bazë në Stomatologji.

Komisioneri e gjen të bazuar dhe në përputhje me kërkesën që miratimi i titullarit të lëndës, formimi i tyre akademik, edukimi bazë, duhet të jetë në përputhje me ekspertizën e lëndës që ata japin. Në këtë këndvështrim, ata duhet të plotësojnë këtë kriter fillimisht dhe pastaj duhet të konsiderohet grada apo titulli akademik që secili prej kandidatëve mund të zotërojë.

Referuar praktikave të Fakultetit të Shëndetit, pranë UV, ndër vite (respektivisht shkresat përkatëse për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022) depozituara pranë KMD-së, evidentohet se kriteri i

¹¹ <https://univloro.edu.al/wp-content/uploads/2015/02/Mimoza-Canga-CV.pdf> (e papërditësuar)

¹² Në argumentimin e DI, për emërimin e pedagogut K. M, si titullar të lëndës “Histologjia dhe Mikrobiologjia” për vitin akademik 2022-2023, është arsyetimi se janë nisur nga fakti se ai është një mjek biokimist dhe mikrobiolog, pra një, mjek i specializuar në këtë fushë dhe me eksperiencë të gjatë si profesionale, ashtu dhe akademike në mësimdhënien e kësaj lënde. Pwr analogji i njwjt i arsyetim wshtw edhe pwr pedagogen A. N, sa i takon faktit se ajo wshtw mjeke.

parë i punësimit në DI ka qenë zotërimi i diplomës në Mjekësi të Përgjithshme ose Infermieri të Përgjithshme (ose specialiteteve përkatëse në bazë të moduleve të ofruara nga DI).

Në asnjë rast, gjatë këqyrjes së këtyre shkresave nuk u evidentua që të ishte kërkuar pedagog i fushës së Stomatologjisë, të gjitha kërkesat ishin për pedagogë të fushave Mjekësi e Përgjithshme (ose specialist) apo Infermieri e Përgjithshme (ose specialist). Në raste të veçanta, janë kërkuar specialist përkatës për module të caktuara: Shëndet Publik, Farmakologji apo Fiziterapi, module të gjitha këto pjesë e kurrikulës së programit të DI.

Programet që ofron Departamenti i Infermierisë janë të përcaktuara në nenin 8, të Regullores së DI, specifikisht si më poshtë:

- Bachelor në Infermieri të Përgjithshme;
- Master Profesional në Infermieri Patologjike;
- Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale;
- Master Shkencor në Shkenca Infermierore .

Me vendimin nr. 44, datë 03.06.2022, “Për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë bachelor në “Infermieri të Përgjithshme”, të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë”, Bordi i Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), bazuar në gjetjet e konstatuara gjatë kontrollit të ushtruar pranë FSHUV, për plotësimin e Standardeve të kërkuara të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Universitetit i janë lënë për plotësim 7 (shtatë) rekomandime specifike, ndër të cilat:

- Institucioni, të marrë masa që, fusha e ekspertizës së personelit akademik që angazhohet në këtë program studimi, të jetë në përputhje me lëndët që ata mbulojnë.
- Institucioni, të marrë masa që i gjithë personeli akademik i angazhuar si lektor në këtë program studimi, të ketë kualifikimin e nevojshëm sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi.
- Institucioni, të përcaktojë si titullarë të lëndëve/moduleve, personel akademik të kategorisë profesor, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Bazuar në sa më sipër, një prej rekomandimeve të lëna në Raportin e Ekspertëve ishte, që duhet të përputhet fusha e ekspertizës së lektorit me specialitetin përkatës të modulit. Për analogji, në këto kushte, edhe nëse do të tolerohej mësimdhënia nga një pedagog i papërputhshëm me specialitetin e modulit, ky pedagog nuk mund të vendoset titullar moduli.

Për rrjedhojë, referuar sa më sipër, krahasimisht me ankuesen, pedagoget A. N dhe K. M, të vendosur si titullarë të lëndëve “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”, zotërojnë diploma në Mjekësi të Përgjithshme (edukimi bazë) kanë përfunduar Specializimet Afatgjata në Mjekësi, në ndryshim nga subjekti ankues e cila edukim bazë ka Stomatologjinë, gjë që bën që fusha e saj e ekspertizës të jetë e papërputhshme me asnjë modul të programit Bsc në Infermieri të Përgjithshme, në DI.

Komisioneri vëren se, vërtet sipas Rekomandimit në fjalë/legjislacionit, titullarët e moduleve duhet të jenë të kategorisë “Profesor”, por së pari ata duhet të jenë të përputhshëm me specialitetin e modulit.

Në këto kushte, edhe pse ankuesja posedon titull akademik më të lartë se dy pedagogët e tjerë të dy lëndëve përkatëse, ka titullin Profesor i Asociuar, që është i një kategorie më të lartë se Doktor Shkencash që zotërojnë dy pedagogët A. N dhe K. M, ajo nuk plotëson kriterin e parë, atë të përputhshmërisë së arsimit bazë, fushës së ekspertizës për këto dy module.

Në rast se ankuesja do të kishte formim bazë në Mjekësi të Përgjithshme apo Infermieri të Përgjithshme, (me plotësimin e kriterit të parë/fillestar, të edukimit bazë në përputhje me fushën e ekspertizës me specialitetin e modulit) atëherë do të merrej në konsideratë vlerësimi i kategorisë së ajo zotëron “Profesor i Asociuar”, i cili do të prevalonte krahasimisht me të dy pedagogët në fjalë.

Nga analizimi i legjislacionit ku rregullohet procedura dhe kompetencat e autoriteteve përkatëse lidhur me propozimin, miratimin e kandidaturave dhe kriteret që ato duhet të plotësojnë për të qenë titullarë të një lëndë, rezulton, se në aktet poshtëcituar parashikohet si më poshtë:

Në nenin 45, të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: “1.Drejtuësi i njësisë bazë është drejtuësi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë. Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë...6. Funkcionet e drejtuesit të njësisë bazë rregullohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë”.

Statuti i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, i ndryshuar, në nenin 38, pika 1, shkronja gj) të tij, ka përcaktuar kompetencat e drejtuesit të njësisë bazë, i cili ndër të tjera ushtron dhe këto funksione:

“...drejtuesi i njësisë bazë përcakton ngarkesën mësimore për personelin akademik të njësisë bazë, pasi ka marrë mendimin e anëtarëve të njësisë bazë dhe ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore për miratim”.

Në nenin 34, të po këtij akti rregullator përcaktohet kompetenca e dekanit për miratimin e propozimit të drejtuesit të njësisë bazë lidhur me sa më sipër.

Neni 30, i këtij Statuti, në pikën 1, të tij, përcakton Rektorin si autoritetin më të lartë akademik të UV-së, dhe përfaqësues ligjor të tij për çështjet akademike dhe protokollare.

Neni 31, i Statutit, përcakton funksionet e Rektorit, ndër të tjera, (pika 14 e tij) duke përcaktuar se ai: “Mund të kthejë për rishqyrtim apo të anullojë, shfuqizojë vendimet e drejtuesve të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë statut, rregullorene UV-së dhe vendimet e Senatit Akademik”.

Rregullorja e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, miratuar nga Senati Akademik me Vendimin nr. 20, datë 11.04.2022, është rregullorja në fuqi, në periudhën në të cilën ankuesja ka kërkuar të jetë

titullare e lëndëve “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”, pasi kërkesa e saj daton në muajin tetor 2022.

Nenet 5 dh 6, të kësaj Rregulloreje, përcaktojnë se:

“5. Njësitë kryesore, njësitë bazë, njësitë ndihmëse me karakter akademik dhe administrativ, bazuar në këtë Rregullore të UV-së, nxjerrin Rregullore të veçanta të brendshme ku përcaktojnë rregulla të hollësishme të veprimtarisë së njësisë përkatëse. Rregulloret e brendshme të njësisë miratohen paraprakisht nga autoritetet drejtuese akademike dhe administrative, nga autoritetet e njësisë ndihmëse dhe miratohen nga Senati Akademik i UV-së”.

“6. Organet drejtuese, autoritetet drejtuese akademike dhe administrative, si dhe autoritetet e njësive ndihmëse të UV nxjerrin vendime, urdhra dhe udhëzime, në përputhje me kompetencat funksionale të tyre të caktuara në ligj dhe në Statutin e UV-së”.

Në nenin 24 , të kësaj Rregulloreje, përcaktohet se: *“1.Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti drejtues akademik i njësisë bazë dhe e përfaqëson atë. Në veprimtarinë e tij mbështetet dhe përfaqëson mendimin e personelit akademik të departamentit. 4. Funksionet e Përgjegjësit të Departamentit janë përcaktuar në neniin 38 të Statutit të UV-së. Përgjegjësi i Departamentit ushtron edhe funksionet e mëposhtme:*

...ë) Propozon kandidaturat për përgjegjës të grupeve mësimore kërkimore/shkencore të njësisë bazë dhe ia përcjell Dekanit për miratim. Kur kandidatura/t refuzohet/n për shkaqe të arsyetuara nga Dekani, atëherë Përgjegjësi i Departamentit, kur i vlerëson të kirëqena shkaqet e refuzimit, pasi merr mendimin e Departmentit, i përcjell Dekanit një kandidaturë tjetër. Në rastin kur refuzimi i kandidaturave konsiderohet pa shkaqe të ligjshme, atëherë Përgjegjësi i Departamentit i paraqet ankim Rektorit dhe kërkon shfuqizimin e aktit të Dekanit dhe miratimin e propozimit të tij. Rektori shprehet me vendim. Kur pranon ankimin ai emëron kandidaturën/at e propozuar/a nga Përgjegjësi i Departamentit. Në rastin kur ankimi nuk pranohet, atëherë Përgjegjësi i Departamenti i përcjell një kandidaturë tjetër, ku reflektohen sugjerimet e Dekanit. Ky rregull zbatohet edhe në rastet e tjera të refuzimit nga Dekani të kërkesë-propozimeve të ardhura nga njësia bazë;

...m) Vendimet e Departamentit merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Departmentit që janë të pranishëm në mbledhje”.

Rregullorja e Departamentit të Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, është akt nënligjor rregullator i miratuar me Vendimin nr. 10, datë 30.05.2013, të Këshillit të Fakultetit të Shëndetit Publik Vlorë, e ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik të UV, me nr. 34, datë 24.03.2017, e cila në nenin 2 të saj ka përcaktuar se:

“Misioni i Departamentit të Infermierisë, si njësi bazë ë FSHP, bazuar dhe në statusin e UV, është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj të tretëve. Bazuar në programet mësimore bashkëkohore, synon të formojë

specialist të lartë në fushën e kujdesit shëndetësor, të kualifikuar dhe të përshtatshëm për tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore.

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore-shkencore dhe administrative të Departamentit të Infermierisë, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të tij dhe e shtrin veprimin e saj mbi njësinë bazë, personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor, personelin administrativ, studentët, bashkëpunëtorët e departamentit si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që vepron në objektet apo territorin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Rregullorja përcakton misionin e programeve të studimit dhe vendos rregullat normative të organizimit të tyre, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunëtorëve, rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për kërkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin, për publikime, për rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores”.

Neni 10, i kësaj Rregulloreje, ndër të tjera, përcakton se:

“1. Drejtuesi i departamentit është autoriteti më i lartë për departamentin. Në veprimtarinë e tij mbështetet dhe përfaqëson mendimin e personelit akademik të departamentit.

2. Veç detyrave të tjera të përcaktuara nga aktet normative në fuqi, përgjegjësi i departamentit ka edhe këto detyra për ushtrimin e funksioneve të tij:

....

f) I paraqet Dekanit listën me propozimet për personelin akademik të ftuar dhe atë me kontratë të përkohshme, me kohë të plotë ose të pjesshme, pas miratimit paraprak në Departament”.

Duke analizuar gjithë sa më sipër, si dhe veprimet e kryera nga Drejtuesja e DI, Komisioneri vlerëson se:

- Sikurse rezultojnë nga veprimet e konstatuara nëpërmjet akteve shkresore, Drejtuesja e Departamentit propozimin për dy pedagogët A. N dhe K. M për të qenë titullarë të lëndëve “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia” e ka diskutuar në mbledhjen e Departamentit dhe e ka kaluar në votim, në prani të anëtarëve të DI.
- Pasi ka marrë dakordësinë e shumicës të anëtarëve të pranishëm në mbledhje (dhe konkretisht sipas procesverbalit të takimit, të të gjithë anëtarëve të Departamentit, përveç votës së vetë ankueses) ka përcjellë për miratim tek Dekania vendimin e Departamentit, i cili është miratuar prej saj dhe më tej është përcjellë në Rektorat.
- Propozimi i Drejtueses së DI është diskutuar në Departament, me të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhjen e mbajtur me temë për zgjedhjen e titullarëve të lëndëve për vitin akademik 2022-2023 (edhe për kërkesën e ankueses për të qenë titullare e dy lëndëve respektive), konform të gjitha akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
- Propozimi është dakordësuar/votuar nga shumica e pjesëmarrësve/anëtarë të DI, të pranishëm në mbledhje.
- Vendimmarrja e DI është një vendimmarrje kolegjiale dhe jo personale e Drejtueses së DI.
- Vendimmarrja e DI është miratuar nga Dekania, që është edhe instancë më e lartë hierarkisht se Drejtuesja e DI.

- Ankuesja ka ankimuar vendimin e Departamentit dhe veprimet e Drejtueses së DI, tek Dekania, e cila i ka kthyer përgjigje se vendimmarrja është e drejtë dhe se nuk konstaton veprime të Drejtueses së DI të cilat të jenë në shkelje të akteve ligjore e nënligjore që ankuesja ka pretenduar dhe ka miratuar vendimin e DI.
- Referuar përcaktimeve respektive të akteve rregullatore sipërcituar, nëpërmjet të cilave përcaktohet procedura nëpërmjet të cilës ankimohet një vendimarrje e Departamentit, Drejtueses së DI, apo e Dekanes, konstatohet se ankuesja nuk e ka shteruar këtë mjet ankimimi deri në fund, tek Rektorati.

Bazuar në analizimin e gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, përsa kohë, nuk konstaton veprime të paligjshme nga ana e Drejtueses së DI, lidhur me propozimin në Departament dhe veprimet e kryera prej saj lidhur me këtë procedurë të caktimit të dy pedagogëve A. N dhe K. M si titullarë të dy lëndëve respektive¹³, për rrjedhje edhe pretendimi e ankueses se nga ana e Drejtueses së DI janë ezauruar paligjshmëri e veprime jashtë kompetencave të saj, nuk qëndron pasi është i pabazuar në prova, fakte e legjislacion.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtueses së Departamentit të Infermierisë, lidhur me propozimin e procedurën e ndjekur për caktimin e pedagogëve A. N dhe K. M si titullarë të dy lëndëve respektive: “Anatomia e Njeriut” dhe “Histologjia dhe Mikrobiologjia”.

Në mungesë të këtij trajtimi, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm me “krahasuesin”, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun/shkaqet” e pretenduar/a.

Rrjedhimisht, Komisioneri gjykon se nuk kemi shkelje të dispozitave ligjore të LMD-së, nga ana e Drejtueses së Departamentit të Infermierisë/ FSHUV, kundrejt subjektit ankues, ardhur për shkak të gjendjes arsimore të saj apo për shkak të konfliktit të krijuar mes tyre, lidhur me sa sipërcituar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

¹³ Anatomia e Njeriut dhe Histologjia dhe Mikrobiologjia

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, M. Ç, në fushën e punësimit, nga ana e Drejtueses së Departamentit të Infermierisë, në Fakultetin e Shëndetit, të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, për shkak të gjendjes arsimore dhe për shkak të konfliktit të krijuar mes tyre.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Çdo shkak tjetër

Lloji i vendimit: Mosdiskriminim